

## VANGJEL DULE



**Datëlindja:** 18.11.1968

**Vendlindja:** Goranxi, Gjirokastrë

**Email:** [Vangjel.Dule@parlament.al](mailto:Vangjel.Dule@parlament.al)

### **Jetëshkrimi:**

Z. Dule ka kryer studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, në degën gjuhë angleze. Ai ka kryer një specializim pasuniversitar, pranë Universitetit të Harvardit.

Karrierën e tij e ka filluar si përkthyes i gjuhës angleze dhe greke dhe gazetar i lirë. Më pas ai ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë në degën e anglishtes.

Për herë të parë zgjidhet deputet në legjislaturën XV të Kuvendit të Shqipërisë, në vitin 1996. Ai ka mbajtur postin e nënkryetarit të Bashkimit Demokratik të Minoritetit Etnik Grek “OMONOIA”, duke u bërë më pas dhe kryetar i saj.

Z. Dule ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë në disa legjislatura si dhe ka qenë anëtar i disa komisioneve parlamentare. Në vitin 2002, ai ka qenë Kryetar i Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Minoriteteve. Nga viti 2009 e në vazhdim ai është anëtar i Asamblesë Ndërparlamentare të Orthodhoksisë.

Nga viti 2013 deri në vitin 2015 ka mbajtur postin e Nënkyetarit të Kuvendit të Shqipërisë.